

## Studimet letrare në proces: teza, projekte, ide dhe rezultate

### **VJOLLCA RRAPAI**

#### **ROMANI EPIK I QAMIL BUXHELIT *KALI I MBRETIT DHE KALORËS TË RINJ***

Veprimtaria krijuese e Qamil Buxhelit karakterizohet nga prirja këmbëngulëse për të vënë në dukje shumë vese, dobësi dhe të meta, ekzistenca e të cilave na bën koshient për dëmin që ato shkaktojnë në shoqërinë tonë. Buxheli këto të meta i solli me aq mjeshtëri përmes humorit dhe ironisë. Me penën e tij nuk qëndroi kurrë pasiv, por gjithmonë ishte pjesë aktive e kritikës për situatat e vështira në të cilat u gjend vendi ynë dhe përmes artit të fjalës, ky shkrimtar dha ndihmesë të veçantë në përparimin e Shqipërisë. Në rininë e tij u dallua për guximin, ndjeshmërinë dhe humanizmin që e karakterizonin dhe pavarësisht vështirësive e situatave me të cilat u përball shumë herë, Buxheli mbeti gjithmonë besnik i idealeve të tij njerëzore.

Pas Luftës së Dytë Botërore proza në letërsinë shqipe dhe sidomos romani nuk pati ndonjë bum botimesh. Me mbarimin e luftës filluan të shkruhen tregime dhe novela ku rrëfesheshin fakte dhe ngjarje reale të asaj periudhe. Kjo prirje e shkrimtarëve lindi edhe si domosdoshmëri për të ruajtur të gjallë përpjekjet heroike të luftëtarëve gjatë pushtimit të vendit. Letërsia shqipe nuk kishte ndonjë traditë të pasur në krijimin e romanit përpara Çlirimit, më pas kësaj gjinie i lindi si “detyrë” të rrëfente në mënyrë artistike idealet e kohës dhe përmes krijimit të personazhit që përfaqësonte frymën e re sociale, subjekti të cilit duhet të sintetizonte përvojën, pikëpamjet, ideologjinë dhe filozofinë e sistemit të ri. Shkrimtarët e realizmit socialist në veprat e tyre trajtuan jetën e mundimshme të popullit shqiptar në përgjithësi dhe fshatarësisë në veçanti, kryesisht gjatë sundimit të mbretit Zog dhe Luftës Nacionalçlirimtare. Këto veçori i shohim në veprat e para të këtij lloji siç janë: “Çlirimtarët” Dhimitër Shuteriqi, “Ata nuk ishin vetëm” Sterjo Spasse, “Përmbysja” Fatmir Gjata etj. Në këto vepra paraqitet shoqëria shqiptare gjatë viteve ’30 e më pas.

Personazhet e këtyre romaneve mbartin filozofinë e ngritjes sa më lart të së kaluarës, të qëndresës heroike kundër forcave pushtuese dhe përqaftimin e ideologjisë së re. Një tjetër shkrimtar shqiptar, Qamil Buxheli, do t’i bashkohej me veprën e tij kësaj filozofie, duke dëshmuar me anë të talentit krijues fakte dhe ngjarje reale të Luftës së Dytë Botërore. Edhe pse në krijimtarinë e tij lëvroi kryesisht zhanrin komik, ai la pas edhe një vepër epike mjaft interesante dhe të dashur për lexuesin, romanin me dy vëllime “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj”. Vëllimi parë i të cilit u botua në vitin 1960 dhe u ribotua në vitin 2002, ndërsa vëllimi i dytë u botua në vitin 2003. Me këtë roman Qamil Buxheli mbrojti diplomën në Institutin e Lartë “Maksim Gorki” në Moskë. Duke qenë se ky roman është shkruar në bazë të dorëshkrimeve dhe kujtimeve të ish - partizanit Hasan

Borshi, siç shprehet vet Buxheli në fund të vëllimit të parë se këtyre kujtimeve u mungonin disa faqe dhe kapituj. Ky roman është interesant për shkak të ngjarjeve që paraqet, për mënyrën se si i shtjellon ato dhe mesazhin që kërkon të përcjell tek lexuesi.

Në dispensën e parë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë letërsia dokumentare artistike mbi Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare shkruar nga pjesëmarrësit në ngjarje shpjegohet më së miri me anë të ditarëve: “Ditari Partizan” është shkruar me intonacionet e një bisede të shtruar. Kjo i ka dhënë veprës një frymë lirike. Ngandonjëherë autori nuk kufizohet me përshkrimin e fakteve po shfaq përshtypjet e veta, arsyeton e jep gjykime rreth ngjarjeve që rrokullisen në sytë e tij. Autori përvijon me ngjyra të goditura disa tipa dhe ngjarje të kohës. Interes paraqesin njerëzit e popullit, mikpritja dhe dashuria me të cilën fshatarët i rrethojnë partizanët, entuziazmi dhe simpatia që ngjall në zemrat e tyre lufta e drejtë dhe qëndrimi zemërhapur i komunistëve”.<sup>1</sup>

Sipas studiuesit të letërsisë shqipe prof. Sh. Sinani letërsia e kësaj periudhe nuk pati ndonjë sukses të madh: “Deri në vitet 1960 “letërsia e re” e realizmit socialist, jo vetëm që nuk njohu ndonjë sukses, por e futi vetveten në një krizë të thellë estetike dhe shprehësie, tematiko - gjinore dhe shqetësimesh qytetare. Megjithatë, në këtë kohë, kur në letërsinë shqipe hyri një brez i ri krijuesish, që nuk kishte pasur ndonjë rol aktiv në luftë, realizmi socialist ishte tashmë një metodë zyrtare, që mbështetej dhe mbrohej nga autoritetet shtetërore dhe partiake”.<sup>2</sup> Të shkruarit e një vepre për të kaluarën dhe mbi të gjitha raportimi i disa fakteve historike nuk do të thotë që në vepër mungojnë elementët artistikë. Shkrimtarët, duke shkruar për të kaluarën, përqendrohen kryesisht në ato tema që lidhen me ngjarje apo personazhe të rëndësishme të një shoqërie. Ndërgjegjja njerëzore ndryshon bashkë me ngjarjet historike, por duke mos hedhur poshtë revolucionet e së shkuarës, faktet apo dëshmitë historike, pavarësisht kohës kur kanë ndodhur. Në të dy vëllimet e romanit “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj” mbizotëron veprimi, personazhet reale që lëvizin me ritëm të shpejtë dhe pasqyrojnë një pjesë të realitetit të Luftës së Dytë Botërore. Nëpërmjet karaktereve kryesore që autori ka zgjedhur bien në sy personazhe pozitive dhe negative, të cilët bëjnë një pasqyrim të sakrificave dhe mundimeve të asaj periudhe historike. Në subjektin e vëllimit të parë vendin kryesor e zënë aksionet luftarake dhe raportet personale mes personazheve kryesore, krijimi i lidhjeve të reja si edhe ëndrra për një të nesërme të lirë.

Romani epik i Qamil Buxhelit “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj” përbëhet nga dy vëllime. Për sa i përket anës kompozicionale romani është cilësuar i arrirë falë lidhjeve logjike dhe ngjarjeve që pasojnë. Vëllimi i parë ndahet në dy pjesë kryesore: pjesa e parë nis me një prolog dhe është e ndarë në njëzet e shtatë

<sup>1</sup> Shih. *Historia e letërsisë shqiptare të realizmit socialist*, (Dispensa e parë), Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1983. f. 122.

<sup>2</sup> Shih Sh. Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të* (studime). Shtëpia Botuese “Naimi”. Tiranë, 2010, f. 432.

### Romani epik i Qamil Buxhelit *Kali i mbretit dhe kalorës të rinj*

---

kapituj, ndërsa pjesa e dytë është e përbërë nga tridhjetë e dy kapituj. Çdo kapitull ka nga një ndarje në paragrafë të shënuar nga një numër, ndërsa kapitujt kanë lidhje logjike me njëri - tjetrin. Marrëdhëniet midis kohës së veprimit dhe kohës së rrëfimit të ngjarjeve në këtë roman luajnë një rol të veçantë. Kjo ndarje mundëson kalimin e ngjarjeve nga njëra tek tjetra dhe zhvendosjen e tyre në mjedise të reja. Për sa i përket vëllimit të dytë, ai përbëhet nga tri pjesë kryesore. Në këtë roman bie në sy mënyra e veçantë se si autori ka ndërthurur raportet kohore në vepër. Buxheli gërsheton kohën e tashme me kohën e shkuar dhe krijon vizionin e vështirimit të drejtpërdrejtë në kohën e tashme të asaj që ka ndodhur. Në roman ndryshimet kohore rrëfohen përmes veprimeve të shumta jetësore, konflikteve dhe ngjarjeve të shumta. Autori vihet në pozitën e atij që ka parë çdo gjë dhe i rrëfen lexuesit detaje të ndryshme nga jeta e personazheve kryesore.

Ngjarjet e vëllimit të parë “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj” zhvillohen në periudhën e Luftës së Dytë Botërore në harkun kohor të viteve 1941 - 1944. Autori rrëfen aksionet e luftëtarëve shqiptarë kundër forcave pushtuese gjermane. Nëpërmjet kujtimeve të luftëtarit Hasan Borshit, tregohen vështirësitë, përballjet, dashuritë dhe mënyra e jetesës së partizanëve shqiptarë. Ngjarjet zhvillohen në jug të Shqipërisë, në çetën e komanduar nga Besniku, ndërsa takimi i parë mes tij dhe Linditës (infermieres partizane) duket se zgjon tek të dy ndjenjën e dashurisë. Autori më pas na njeh edhe me figurën e Mërkurit, një personazh enigmatik, i cili dëshiron gjithashtu të fitojë zemrën e infermieres. Merkuri përpiqet më çdo kusht të fitojë besimin e komandantëve dhe drejtuesve kryesorë, pavarësisht se në arritjen e këtij qëllimi ai ndihmohet nga forcat kundërshtarë brenda vendit por edhe nga forcat pushtuese. Për të realizuar qëllimin e tij ky personazh shpeshherë vendoset në “situata dramatike”, siç është rasti i minimit të urës së Dobrovës, kur pasi hedh urën në erë edhe pse i “plagosur” përpiqet më çdo kusht të shpëtojë shokët e tij partizanë. Në vëllimin e parë Buxheli është kujdesur të rrëfej me përpikëmeri vështirësitë dhe mirorganizimin e partizanëve për të fituar mbi pushtuesit.

Romani ynë epik i shkruar gjatë realizmit socialist e paraqet mënyrën e jetesës në plane të shumanshme, ndërsa populli luan rolin e personazhit “kolektiv”. Personazhet e romaneve historike mishërojnë idealet çlirimtare dhe shumë infermieres herë, si në rastin e Besnikut apo Agimit, e shohin vdekjen me optimizëm dhe në asnjë rast ata nuk janë komikë. Të gjitha veprimet, idetë dhe reagimet emocionale i shohim në këtë prizëm, çdo gjest, çdo sjellje dhe format e mendimit shpjegojnë edhe statusin shoqëror të personazhit që trajtohet. Pjesa e parë e romanit “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj” përfundon me një takim midis Linditës dhe Besnikut kur ata i rrëfejnë njëri - tjetrit ndjenjat, por për fat të keq dashuria e tyre nuk kurorëzohet me një lidhje, ajo mbetet dashuri në planin platonik. Janë ditët e fundit të luftës dhe Besniku largohet në Malin e Zi, ku është vënë në ndjekje të gjermanëve. Në fundin e pjesës së parë të romanit shfaqet në skenë edhe i fejuari në djep i Linditës, Ylli. Takimi mes dy të fejuarve në djep është një ndër fragmentet e pakta në vepër kur Buxheli përshkruan gjendjen psikologjike të personazhit. Në këtë vëllim rrëfohen situata jetësore e shoqërore,

fakte, ndodhi, peripecitë dhe rrethanat në të cilat gjenden e veprojnë personazhet kryesore, por edhe ndryshimet që ndodhin në jetën e tyre në periudhën e luftës dhe gjatë viteve të para pas çlirimit.

Vëllimi i dytë botuar në vitin 2003, nis me përshkrimin e ngjarjeve të vitit 1944 në ato ditë të rëndësishme për popullin tonë pikërisht më 28 - 29 nëntor, ditët kur pushtuesit gjermanë largohen nga Shqipëria. Kritiku i letrave shqipe Koço Bihiku në artikullin me titull “Një vepër epike për luftën antifashiste” kushtuar botimit të dytë të këtij romani vlerëson në mënyrë të veçantë “rrëfimin” e Q. Buxhelit si pjesëmarrës i lëvizjes popullore çlirimtare kundër pushtuesit: “Romani, “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj”, ku nëpërmjet pamjeve të gjalla artistike, lexuesit e rinj do të krijojnë një përfytyrim të saktë për luftën e popullit tonë kundër pushtuesve të huaj dhe rëndësinë që pati fitorja mbi ta për ngritjen e një Shqipërie të popullit pas Luftës së Dytë Botërore mbi vlerat morale dhe historike të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare”.<sup>3</sup>

Personazhet kryesore të vëllimit të parë paraqiten tani në pozita të tjera. Mërkuri punonte në Degën e Punëve të Brendshme në Tiranë. Besniku është plagosur rëndë në këmbë e në sy, ndërsa shoku i tij i luftës Agimi dhe rival në dashuri e shoqëron atë për në spitalin e Tiranës. Lindita (me ndihmën e Mërkurit, por pa dijeninë e saj) punon si infermiere në një nga spitalet e kryeqytetit. Gjatë vizitës së infermieres partizane në spitalin ku qëndronte Besniku, tek ajo zgjohet edhe një herë ndjenja e dashurisë për komandantin e dikurshëm. Pas një bisede të ngrohtë mes dy të rinjve në skenë shfaqet nëna e Agimit, e cila i rrëfen Besnikut lidhjen e Agimit me Linditën, fejesën e lidhur që në djep dhe i lutet atij mos të prishë dashurinë e tyre. Besniku pëson një tronditje të rëndë psikologjike kur mëson lajmin se dashuron të njëjtën vajzë me shokun e tij të ngushtë Agimin, dhe pa pasur kohë e mundësi të sqarohet me Linditën ai nisat urgjent për t’u mjekuar në Moskë.

Një rol të rëndësishëm në vëllimin e dytë ka edhe personazhi i Mejremes, nënës së Besnikut, këtu ajo shfaqet më aktive. Autori fillimisht rrëfen peripecitë e saj në internim, në burgjet e Malit të Zi, marrëdhëniet me të burgosurat e vendeve të tjera evropiane dhe bashkëpunimet me forcat partizane malazeze. Ajo flet edhe për kthimin e saj në Tiranë dhe zhgënjimin që pëson nga shtresat qeverisëse. Pas disa kohësh Merjemja takon Mërkurin në shtëpinë e tij, në momentin kur ky i fundit ishte duke u arratisur nga Shqipëria. Nga ana tjetër ndjenjat e Mërkurit për Linditën po bëheshin gjithnjë e më të forta, shpresonte çdo ditë e më shumë se dy rivalët e tij ishin larguar përgjithmonë nga jeta e vajzës që ëndërronte. Kjo dëshirë e zjarrtë për të pasur në krahët e tij Linditën, ky pasion i madh e shtyn Mërkurin në një akt dhune kundrejt saj. Duket sikur këtë situatë autori e krijon për të treguar se deri ku mund të shkonte ligësia në figurën e personazhit të Mërkurit.

Ngjarjet në roman do të marrin një tjetër rrjedhë për Mërkurin, pasi kryen vrasjen e Mejremes. Ai përpiqet me çdo kusht të largohet nga Shqipëria, aq sa

<sup>3</sup> K. Bihiku, *Një vepër epike për luftën antifashiste (Shënime për romanin “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj”) të Qamil Buxhelit*, “Drita”, 29 qershor 2003, f. 4.

arrin ta bindë vajzën e re se do të shkonin në Bashkimin Sovjetik dhe të dy nisen në udhëtim me një anije, por Lindita në bashkëpunim me motoristin e përmbysin planin e Mërkurit. Gjatë pasqyrimin të veprimtarisë së forcave pushtuese autori përmend edhe disa fakte reale të njohura për lexuesin. Në fund të romanit Besniku kthehet nga Bashkimi Sovjetik dhe takohet me Agimin, i cili i tregon për vendimin e prishjes së fejesës me Linditën, duke iu lënë rrugë të lirë në dashurinë e tyre. Në këtë vepër ndihet fryma dhe ideologjia e kohës në të cilën u shkrua, bie në sy rrëfimi i marrëdhënieve të shtetit shqiptar me Bashkimin Sovjetik si edhe ndikimi i ideologjisë komuniste ruse në jetën e personazheve tona. Në të dy vëllimet e romanit “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj”, Q. Buxheli, është kujdesur të rrëfejë në mënyrë të përgjithshme rrjedhën e ngjarjeve, pa u ndalur gjatë në përshkrimin e botës së brendshme të personazheve. Nga pikëpamja kohore romani është strukturuar në mënyrë të ndryshme. Në momentet kur personazhet rrëfejën të kaluarën, por ka raste kur këto ngjarje aktualizohen nga rrëfimtari, koha e shkuar është gërshetuar me kohën e tashme.

**Karakterizimi i personazheve në romanin “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj”**

Në strukturën e formimit dhe zhvillimit të personazheve të romanit “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj” dallojmë dy tipa kryesorë. Së pari vihet re paraqitja e vetëdijes shoqërore të personazheve kryesore përpara një ngjarjeje të madhe historike dhe kjo gjë arrihet përmes përshkrimit narrativ, dhe së dyti përshkrimi i personazheve në planin personal, duke i vendosur ata në situata dhe zgjedhje të vështira. Në këtë roman veprojnë katër personazhe kryesore: Besniku, Agimi, Lindita dhe Mërkuri si edhe një sërë personazhesh episodike, ndër të cilët dallohen xha Shamenti, Mejremja, Vitoria, Gestapua, doktor Hamiti, doktor Gjerasi etj. Rrëfimi në roman është përqendruar rreth jetës dhe fatit të katër personazheve kryesore: Besnikut komandant i një batalioni antifashist në Shqipërinë e Jugut, Agimit komisar i batalionit drejtues dhe partizan i zoti (i fejuari në djep i Linditës), Mërkuri personazhi me rol të dyfishtë brenda veprës dhe Linditës infermieres partizane.

Karakteret e personazheve të kësaj vepre shpalosen përmes situatave dhe episodeve konkrete, përmes cilësive morale dhe shpirtërore. Personazhet pozitive në roman veprojnë mbi bazën e motivit ideologjik me anë të së cilit shkrimtari arsyeton karakterin, temperamentin dhe mënyrën e jetesës së tyre. Autori i këtij romani nëpërmjet motivacionit ideologjik gërsheton veprimet dhe botën emocionale të karaktereve, duke dashur t’i bëjë me dije lexuesit të kaluarën e vështirë dhe të mundimshme nëpër të cilën kaluan partizanët. Buxheli ka treguar edhe rrugën e formimit të heronjve të tij si një proces në lëvizje dhe në kohë, duke iu përshtatur kërkesave revolucionare të cilat zgjuan ide të reja për jetën. Me kalimin e kohës karakteret e Buxhelit ndryshojnë, fitojnë tipare të reja, bëhen më të dashur për lexuesin dhe më të vendosur se kurrë për të realizuar misionin e tyre në rrugën e gjatë e të vështirë për të fituar lirinë.

Qamil Buxheli krahas luftës në terren dhe intrigës kryesore që përshkon gjithë romanin të ngjallë kureshtje edhe përmes intrigës së dytë që zhvillohet në vepër, e cila krijohet prej raporteve të Linditës me tri personazhet meshkuj, Besnikun,

Agimin dhe Mërkurin. Kjo intrigë është thurur me mjaft mjeshtëri nga autori, duke paraqitur edhe anët e errëta të traditës shqiptare kur fëmijët fejojeshin që në djep dhe nuk kishin mundësi ta njihnin njëri - tjetrin deri sa të martoheshin dhe rrallë herë ndodhte që të rinjtë të kundërshtonin zgjedhjet e prindërve të tyre. Nga ky zakon i vjetër shqiptar lindin edhe mosmarrëveshjet e Agimit me Besnikun në momentin kur marrin vesh se dashurojnë të njëjtën vajzë.

Një karakteristikë e veçantë e personazheve të këtij romani është se çdo njeri prej tyre paraqitet në funksion të një ideje të caktuar për të shpalosur në mënyrë sa më reale realitetin jetësor. Në këtë vepër nuk mungojnë edhe situatat kur personazhet shfaqen me luhatjet e tyre psikologjike, kjo gjë e bën lexuesin kurioz për veprimet e tyre të mëtejshme. Realitetin e luftës Buxheli e paraqet përmes vështirësive dhe sakrificave të shumta me të cilat përballen heronjtë e këtij romani me pushtuesit. Ka raste kur karakteristikat e secilit personazh jepen në mënyrë specifike duke bërë të mundur zbërthimin e botës së brendshme të gjithsecilit. Personazhi i Mërkurit duket se është një nga më të realizuarit edhe për disa veçori të tjera, siç është etja për pushtet, tërheqja mbas femrave, dashuria e sinqertë për Linditën, por herë - herë edhe dëshira e tij e mirë për ta nisur jetën nga e para me infermieren partizane. Dy personazhet e tjerë meshkuj, Besniku dhe Agimi janë dy karaktere të ndryshme. Besniku është kokëfortë, i shkathët, trim dhe ndonjëherë edhe i nxituar në veprime, ndërsa Agimi është i matur, i qetë, i urtë dhe i kujdesshëm. Autori jo pa qëllim i vendos ata në disa situata të përbashkëta për t'i përballur më vonë me zgjedhjen e Linditës mes dy shokëve. Një ndërlikohëse e mirë mes këtyre tri personazheve meshkuj është pikërisht Lindita, e cila gjithashtu zë një vend të rëndësishëm në të dy vëllimet. Ajo është një vajzë e re, e bukur dhe tërheqëse. Buxheli nuk është ndalur gjatë në përshkrimin e saj fizik, por është kujdesur që të shpalosë sa më mirë botën e saj të brendshme, çiltërsinë dhe dashurinë për jetën dhe njerëzit në përgjithësi.

Nga personazhet e dorës së dytë në roman veçojmë figurën e xha Shametit, i cili përmes batutave dhe mençurisë që e karakterizojnë sjell disa herë nota humoristike në vepër. Ky karakter përfaqëson më së miri psikologjinë e njerëzve të thjeshtë sepse është i dashur dhe i kuptueshëm për lexuesin. Me thjeshtësinë e tij, ky personazh tregon vuajtjet e popullit tonë në të kaluarën, dëshirën dhe pasionin për të përqaftuar të renë, por edhe shpirtin e tij luftarak e atdhedashës. Autori i ka kushtuar kujdes të veçantë shtjellimit të veprimit, përshkrimit të detajuar të mjedisit dhe situatave në të cilat janë gjendur personazhet e tij. Në zgjidhjen e konflikteve Buxheli krijon alternativa dhe mundësi të ndryshme, kjo edhe në varësi të karakterit individual që përfaqëson secili personazh.

#### **Përfundime:**

Në të dy vëllimet e romanit “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj” të Qamil Buxhelit mbizotëron veprimi, personazhet reale që lëvizin me ritëm të shpejtë dhe pasqyrojnë një pjesë të realitetit të Luftës së Dytë Botërore. Autori në këtë vepër pasqyron edhe hallet e vuajtjet e popullit shqiptarë, varfërinë e fshatarëve dhe dëshirën e përbashkët për të jetuar të lirë në vendin e tyre. Personazhet e romanit

### Romani epik i Qamil Buxhelit *Kali i mbretit dhe kalorës të rinj*

---

“Kali mbretit dhe kalorës të rinj” kanë synime të qarta për jetën dhe të ardhmen. Ata luftojnë me çdo kusht pushtuesin dhe shpresojnë ta shohin Shqipërinë e lirë. Nëpërmjet rrëfimit të autorit shpaloset edhe dashuria e këtyre personazheve për vendin, forca e karakterit, guximi dhe besimi për të qenë të lirë. Në këtë vepër Qamil Buxheli pasqyron një sërë aspekte të jetës siç janë: lufta për liri, lufta kundër armiqve pushtues, dashuria dhe miqësia, vuajtjet, humbjet, përballjet, vrasjet dhe gëzimet.

#### **BIBLIOGRAFI**

- D. Agolli, *Një personalitet i shquar i kulturës dhe letërsisë së re shqiptare (shkrimtari Qamil Buxheli)*, “Zëri i popullit”, 30 maj 204.
- M. Gurakuqi, *Kali i mbretit dhe kalorës të rinj*. “Zëri i popullit”, 17 mars 1961.
- N. Lezha, *Suksesit i romanit tonë me temë historike*, “Nëntori”. nr. 1, 1971, Tiranë.
- R. Brahimi, *Njerëz, jini vigjilentë!* (Shënime për romanin “Kali i mbretit dhe kalorës të rinj”). Në: R. Brahimi, “Shënime letrare”, Tiranë: “Naim Frashëri”, 1965.
- Sh. Sinani, *Për letërsinë shqipe të shekullit të 20-të* (studime). Shtëpia Botuese “Naimi”. Tiranë, 2010.

